

**Informacion mbi pjesëmarrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Kongresin Ndërkombëtar 2017, organizuar nga Instituti Ndërkombëtar i Shkencave Administrative (IIAS)**

**30 Maj – 02 Qershor 2017**



Në kuadër të anëtarësimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Institutin Ndërkombëtar të Shkencave Administrative (IIAS), i cili është një organizëm ndërkombëtar që operon në fushën e administratës publike, në datat 30 Maj – 02 Qershor 2017, u organizua Kongresi Ndërkombëtar 2017, në Aix-en-Provence, Francë, ku ishin të ftuar të merrnin pjesë të gjithë institucionet e

anëtarësuar në këtë organizëm, ndër të cilët edhe KMSHC.

Përveç temës kryesore të këtij kongresi: *“Midis politikës dhe administratës publike: Mbretërimi i nepotizmit”*, fokus i veçantë iu kushtua edhe emigracionit në rritje të kohëve të fundit, mundësive jo vetëm për pranimin e emigrantëve por edhe integrimin e tyre në shoqëri në përgjithësi dhe në administratën publike në veçanti, duke qenë të bindur se ksenofobia nuk ka sens në një botë që po rend gjithmonë e më shumë drejt shkrirjes së kufijve.